

Parafjalë

Kur pas Luftës II Botërore vendi po përpiquej të shëronte plagët, kur për politikën nuk dukej të frynin erëra të mbara, por në art e kulturë po bulonin institucionet e para, në Shqipëri krijonte Bojan Adamiçi, një kompozitor dhe intelektual i shquar slloven, për të cilin pak ose aspak është folur, por që tashmë na vjen përmes një botimi të vlerë të akademikut Vasil S. Tole. Një vepër e pasur muzikologjike mbi veprimtarinë e Adamiçit (1912-1995), me dokumente origjinale dhe kujtime që hapin një dritare njohjeje jo vetëm për këtë personalitet të muzikës në rajon, por edhe për zhvillimet sociale e kulturore në periudhën kur ai jetoi në Shqipëri.

Ishin vitet 1947-1948, një kohë e trazuar politike, sociale dhe ekonomike, që përkuan me kulmimin dhe më pas kadencën e “miqësisë” shqiptaro-jugosllave, por kur arti, posaçërisht ai muzikor, po kërkonte hapësira lirie e shprehjeje në raport me institucionet tradicionale dhe ato të reja që po krijoheshin.

Ashtu siç edhe na rrëfëhet përmes faqeve të këtij libri, vitet e para pas Luftës II Botërore paraqiten mjaft interesante në këndvështrimin muzikor, nisur sa nga situata artistike e pangjashme me vende të tjera e po aq me dinamikën e zhvillimeve që sollën më pas në muzikën profesioniste shqiptare. Klasa muzikore shqiptare, një klasë elitare e intelektuale e formuar në perëndim në vitet 1920-1940, së bashku me formacionet muzikore pranë Radio Tiranës, Korit të Shtetit dhe ato të Ushtrisë Popullore, mbajtën gjallë jetën muzikore në vend, jo rrallë herë, në kushte të vështira jetësore e materiale.

Por ishin ato tharmi në rritjen dhe shtrirjen e rolit të muzikës në shoqërinë shqiptare, që natyrshëm solli edhe nevojën e krijimit të institucioneve muzikore, që nga Liceu Artistik (1946), Komisioni për shqyrtimin e muzikës (1947), të formacioneve muzikore profesioniste shtetërore, Filarmonia Shqiptare (1952) dhe Teatri i Operës (1953), krahas krijimit të dhjetëra ansambleve, orkestrave frymore dhe koreve muzikore gjysmëprofesioniste, kryesisht në qytetet me tradita kulturore të trashëguara.

Në këtë hark të shkurtër kohor që përfshin vitet 1947-1948, shpaloset edhe kontributi i Bojan Adamiçit në Shqipëri. Për herë të parë vepra e akademikut Vasil S. Tole na zbulon dimensionin e një figure, dëshmitare e kësaj periudhe të muzikës sonë, të ndriçuar jo aq sa duhet deri më tani. Duhet ta konsiderojmë fat që Bojan Adamiçi erdhi në Shqipëri dhe dha me bujari e profesionalizëm kontributin e tij në jetën tonë muzikore në disa drejtime, të cilat janë trajtuar gjerësisht në libër.

Formimi, talenti, përkushtimi i tij në ato vite ishin me rëndësi për mbështetjen dhe zhvillimin e muzikës së kultivuar në Shqipëri.

Përveçse një hapësirë njohëse, një kontribut në historinë e zhvillimeve muzikore, një homazh dhe nderim për këtë figurë të shquar, ky libër është edhe shenjë e bashkëpunimit dhe miqësisë së kahershme shqiptaro-slllovene, që, me siguri, do të gjallojnë me të tjera projekte, që forcojnë më tej urat tona të komunikimit.

Elva Margariti

Ministre e Kulturës